



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1912/1 Prot.

Tiranë, më 16 / 12 / 2019

V E N D I M

Nr. 187, Datë 16 / 12 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 111, datë 13.09.2019, të L.Dh kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Në Buletinin nr.24, datë 17.06.2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik është shpallur njoftimi për një vend të lirë pune si asistent-lektor në Departamentin Biologji-Kimi. Bazuar në këtë njoftim, ankuesja ka dorëzuar dokumentet e kërkuara pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore. Ankuesja shprehet se, zhvillimi i këtij konkursi dhe vendimi përfundimtar, është bërë në kundërshtim me ligjin, pasi është bërë në mungesë të plotë transparence, duke mos u shpallur njoftimi në faqen zyrtare të internetit të USH-së¹ si dhe duke e mosinformuar ankuesen për vendimin e aplikimit të saj. Në këtë aspekt, ankuesja është vënë në dijeni të vendimit, pasi ka bërë kërkesë me shkrim, në datë 31.07.2019. Me shkresën nr. 2754/1, datë 23.08.2019 është informuar nga Rektorati i USH-së, për skualifikimin e saj për arsye të mospërmbushjes së kriterit, “kandidati duhet të jetë diplomuar “Master i Shkencave” në “Biologji Molekulare” ose ekuivalent jashtë vendit”. Ankuesja informon se, ka përfunduar studimet në vitin 2005 në Degën Biologji-Kimi, me mesatare 9.37 dhe referuar pikës 2, të nenit 124 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”, diploma e studimeve me kohë të plotë 4-vjeçare*

¹ Shkurtesë për Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

është e ekuivalentuar me diplomë “Master i Shkencave”. Në ato vite këto diploma nuk kanë patur ndarje në drejtime, që do të thotë se diploma të tilla janë gjithëpërfshirëse duke përfshirë dhe biologjinë molekulare. Në vitin 2016 ankuesja ka marrë gradën shkencore “Doktor i shkencave” në drejtimin Biologji Molekulare. Pra, kriteri “Master i Shkencave” me drejtim Biologji Molekulare nuk mund të jetë përjashtues për të”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, anulimin e vendimit përfundimtar dhe përsëritjen e konkursit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 111, datë 13.09.2019, të L.Dh kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Me shkresën nr. 1361/2, datë 18.09.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Universiteti i Shkodrës për ankesën e bërë nga L.Dh si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituarat:
 - Kopje të procedurës (procesverbalit/eve) të propozimit të Departamentit Biologji-Kimi për kriteret që duhet të plotësonin kandidatët për personel akademik për vendin e lirë të punës të shpallur në Buletinin nr. 24, datë 17.06.2019. *(arsyetimin që është përdorur nga departamenti për vendosjen e kriterëve: - 2. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë “Master i Shkencave” me drejtim “Biologji Molekulare” me notë mesatare jo më të ulët se 8.5. – 3. Të ketë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë “Master i Shkencave” ose “DIND” (300 ECTS) në profilin “Biologji Molekulare”, me notë mesatare mbi 8.5. Shpjegime të arsyes së përjashtimit të kandidatëve që janë diplomuar në programet e studimit që kanë zgjatur 4 vite akademike (8 semestra) në degën Biologji-Kimi.*
 - Kopje të shpalljes së vendin vakant të bërë në faqen e internetit të USH-së.
 - Kopje të vendimit për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për vlerësimin e kandidatëve.
 - Kopje të procedurës së ndjekur për vlerësimin e kandidaturave për pozicionin e asistent-lektor me kohë të plotë për seminarët dhe laboratorët e lëndës “Bio-Kimi Mjekësore” në degët bio-kimi, infermjeri, fizioterapi, mami dhe lënda “Bio-Kimi” në degët Bio-Kimi dhe Edukim Fizik. (Kopje të akteve: shpallje, procesverbale, etj).
 - Kopje të procedurës së ndjekur nga USH për vlerësimin e ankueses.
 - Kopje të procedurës së ndjekur nga USH për shpalljen e kandidaturës fituese. (Shpallje, provesverbale të mbajtura, etj).
 - Kopje të korrespondencës së mbajtur me ankuesen (kërkesa dhe kthim përgjigje).
 - Informacion mbi raste të tjera të ngjashme të skualifikimit të kandidatëve për mosplotësimin e kriterit, të ketë kryer studimet me kohë të plotë me diplomë “Master i Shkencave”, (nëse ka).

Me shkresën nr. 3105/1, datë 25.09.2019, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka dërguar bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, pa paraqitur parashtrime specifike. Dokumentacioni i dërguar nga USH është marrë në konsideratë nga Komisioneri në kontekst të vlerësimit të fakteve dhe provave të çështjes, në funksion të vendimmarrjes së tij.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë të pretenduar nga subjekti ankues.

Referuar njoftimit të bërë në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 24, datë 17.06.2019, për një vend pune në pozicionin e asistent-lektore me kohë të plotë për seminarët dhe laboratorët e

lëndës “Bio-Kimi mjekësore” dhe lëndës “Bio-Kimi” pranë Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ankuesja ka paraqitur aplikimin e saj.

Njoftimi ka të specifikuarat kërkesat që kandidatët duhet të plotësojnë për këtë pozicion pune, në kritere specifike dhe kritere të përgjithshme. Kështu, në mënyrë të detajuar janë përcaktuar:

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike:

1. Të ketë kryer ciklin e parë të studimeve në sistemin me kohë të plotë, në programet e studimit “Biologji ose “Biologji-Kimi” me notë mesatare jo më të ulët se 8.5.
2. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë “Master i Shkencave” me drejtim “Biologji Molekulare” me notë mesatare jo më të ulët se 8.5.
3. Të ketë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë “Master i Shkencave” ose “DIND” (300 ECTS) në profilin “Biologji Molekulare”, me notë mesatare mbi 8.5. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MASR.
4. Të ketë dhënë domosdoshmërisht provim lëndën për të cilën pretendojnë të jenë mësues dhe të kenë mesatare të grup-lëndëve të bio-kimisë mbi 9.
5. Të ketë të mbrojtur një nga gjuhët e huaja të BE-së, me notë jo më të ulët se 8 ose të ketë mbrojtur një nga pesë gjuhët e njohura nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1.
6. Preferohet që të kenë publikime që vërtetojnë aftësi në kërkimin shkencor dhe potencial për aktivitet të suksesshëm në universitet.
7. Preferohet që të kenë eksperiencë pune mbi dy vjet në mësimdhënie në profilin Bio-Kimi.

Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të kenë aftësi të punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
2. Të mos jetë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
4. Të mos jetë larguar nga USH “L.Gurakuqi” pa miratimin e këtij të fundit.
5. Të mos ketë prishur në mënyrë publike imazhin e USH “L.Gurakuqi”.
6. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj) apo krushqie (prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjës ekzistues brenda të njëjtës njësi bazë apo ndihmëse ku kërkojnë të punësohen.

Ankuesja duke mos marrë përgjigje lidhur me procedurat e konkursit, me shkresën datë 06.08.2019 i është drejtuar me ankesë, Rektorit të USH-së.

Universiteti i Shkodrës me shkresën nr. 2754/1, datë 23.08.2019, në mes të tjerash informon ankuesen se, konkursi është zhvilluar sipas të gjitha parashikimeve ligjore, dhe se përzgjedhja dhe vlerësimi i kandidatëve është bërë nga Komisioni Ad-Hoc, si dhe i ka vënë në dispozicion kopje të proces verbalit nr. 46, datë 29.07.2019 të mbajtur nga Komisioni Ad-Hoc.

Referuar Proces verbalit Nr. 46, datë 29.07.2019, në procedurat e konkurimit për pozicionin e shpallur kanë konkuruar 3 kandidatë (S.D, L.Dh dhe D.L). Komisioni Ad-Hoc ka vendosur skualifikimin e kandidates S.D për mosplotësim të kriterit nr. 1 dhe kriterit nr. 3 tek kriteret specifike, sipas të cilëve mesatarja e studimeve bachelor duhet të jetë mbi 8.5.

Referuar Proces verbalit Nr. 46, datë 29.07.2019 të mbajtur nga Komisioni Ad-Hoc, kandidatja L.Dh është skualifikuar pasi nuk plotësonte kriterin nr. 2, tek kriteret specifike të shpallura nga USH-ja, si dhe kriterin nr. 2 tek kriteret e veçanta të shpallura nga Departamenti për këtë vend pune sipas të cilit kandidati duhet të jetë diplomuar “Master i Shkencave” në “Biologji Molekulare” ose ekuivalent jashtë vendit, dhe është kualifikuar vetëm një kandidate për në fazën e dytë, D.L që është shpallur dhe fituese në përfundim të procedurave të konkurimit.

Vendosja e kriterëve për punësimin e personelit akademik është parashikuar në Statutin e Universitetit të Shkodrës³ i cili në nenin 42/2 dhe 43/2, parashikon, si më poshtë: 42/2: *“Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën “Master i Shkencave” dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në “Rregulloren e zënies dhe ruajtjes së vendit të punës” të USH-së dhe kriteret e posaçme të përcaktuara nga departamenti përkatës”*. Ndërsa në nenin 43/2 parashikohet se: *“Kriteret specifike të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga rektori”*.

Sikurse vihet re nga parashikimi i nenit 43/2, kriteret specifike të konkurimit propozohen nga njësia bazë, që konsiderohet Departamenti përkatës, i Fakultetit të USH-së. Më pas, lista e këtyre kriterëve miratohet nga Rektori i USH-së, i cili konsiderohet si autoriteti përgjegjës i gjithë këtij procesi.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar shpjegimet e nevojshme dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues. Universiteti i Shkodrës ka dërguar vetëm dokumentacionin e kërkuar dhe nuk ka dhënë shpjegime mbi arsyet e vendosjes së kriterëve specifike, 2 dhe 3.

Lidhur me sa më sipër, në kontekst të përmbushjes dhe plotësimit të kriterëve të përcaktuara, Komisioneri konstaton se:

- Lidhur me kriterin specifik:

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64/1 të tij, ka parashikuar se: *“Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori. Konkursi në institucionet publike të arsimit të lartë drejtohet nga një komision Ad-Hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit Ad-Hoc, si dhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në statutin e IAL-së”*.

³ Miratuar me Urdhrin nr. 366, datë 05.07.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Në zbatim të sa më sipër, Departamenti i Biologji-Kimisë ka vlerësuar vendosjen e kriterëve specifike. Subjekti ankues është skualifikuar për mospërmbushje të kriterëve specifike, dhe konkretisht:

- Në njoftimin e sipërcituar, lidhur me kriterin e përcaktuar si kriter specifik, USH ka listuar si kriter përjashtues që kandidati duhet: *“Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë “Master i Shkencave” me drejtim “Biologji Molekulare” me notë mesatare jo më të ulët se 8.5”.*

Lidhur me plotësimin e këtij kriteri nga ana e subjektit ankues, Komisioneri konstaton se, L.Dh, bazuar në dokumentacionin e depozituar në dosje, rezulton të jetë diplomuar në degën “Biologji-Kimi” në vitet akademike 2001-2005, diplomë 4-vjeçare, sipas sistemit të mëparshëm, të kohës kur është diplomuar, dhe me Diplomë Doktorate me Nr. regj të KVTA 1935, datë 19.04.2016, ka fituar gradën shkencore “Doktor” në Biologji Molekulare pranë Universitetit të Tiranës.

Neni 124/2 i Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka përcaktuar se: *“Diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat “Master i Shkencave”.* Ky ligj ka përcaktuar fushat dhe programet e studimit të cilat ofrojnë programe të integruara të nivelit të dytë.

Pra, në interpretim të sa më sipër, diploma e L.Dh është ekuivalente me diplomën e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”, gjë që bën që ajo të përmbushë kriterin e përcaktuar nga Departamenti i Biologji-Kimisë, sa i takon kërkesës për diplomë të nivelit të dytë “Master i shkencave”, për më tepër që ankuesja zotëron gradën shkencore “Doktor” në drejtimin “Biologji Molekulare” që është një kualifikim dhe më i thelluar i njohurive për kriterin e vendosur “Master i Shkencave” me drejtim “Biologji molekulare”.

Referuar legjislacionit në fuqi⁴ dhe dokumentacionit të shqyrtuar në lidhje me procedurat e punësimit për personelin akademik me kohë të plotë, vërehet se në aktet e përmendura nuk ka një rregullim të saktë dhe të qartë mbi mënyrën e përcaktimit të kriterëve specifike për staf akademik si dhe nuk është përcaktuar detyrimi që duhet të kenë njësitë përkatëse (Departamenti) për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kriterëve specifike të propozuara.

Duke iu përmbajtur kriterit specifik të përcaktuar në pikën 2, të njoftimit në Buletinin nr. 24, datë 17.06.2019, rezulton se në bazë të tij, përjashtohen nga konkurimi në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë kandidatët që zotërojnë një diplomë, që ka zgjatur 4 vite akademike (8 semestra), në fushën Biologji-Kimi, pavarësisht se mund të jenë me tituj shkencor më të lartë se kriteret e kërkuara. Ky kriter bëhet dhe më i pakuptimtë kur kandidatja plotëson kriterin e diplomimit të ekuivalentuar në master shkencor dhe doktoraturë në fushën e biologjisë molekulare, por studimet i ka përfunduar përpara periudhës kur ka filluar zbatimi i procesit të Bolonjës, kusht në të cilin ndodhet ankuesja e skualifikuar.

⁴ Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Shkodrës.

Në kontekst të analizimit të fakteve sipër përmendur, Komisioneri vlerëson se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, pikërisht për sa i takon vendosjes së kriterit specifik nr. 2, të vendosur nga Departamenti i Biologji-Kimisë, duke e vlerësuar si përjashtues.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7/1⁵ të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, subjekti ankues është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁶, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Ankuesja ka pretenduar në thelb, trajtim të padrejtë, nga ana e Universitetit të Shkodrës dhe Komisionit të Vlerësimit, bazuar në vendosjen e kriterit specifik nr. 2.

Gjatë parashtrimeve të saj, ankuesja ka pretenduar dhe diskriminim “për çdo shkak tjetër”, duke argumentuar se vendosja e kriterit specifik ka bërë që ajo të jetë diskriminuar nga ana e USH-së përmes skualifikimit të saj.

Komisioneri konstaton se ankuesja në vetvehte e gëzon kualifikimin e duhur për pozicionin e shpallur. Vendosja e kriterit specifik nr.2, ka bërë që ankueses dhe të gjithë kategorisë së aplikantëve konkretë apo qoftë dhe potencial, të cilët gëzojnë një diplomë, që ka zgjatur, 4 vite akademike (8 semestra), në fushën Biologji-Kimi, ka bërë që ata të përjashtohen nga konkurimi, duke u hequr të drejtën dhe mundësinë kësaj kategorie, që t’i nënshtrohen një procesi të rregullt dhe të drejtë konkurimi.

⁵ Neni 7/1, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

⁶ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim”.

Përkatësinë e ankueses dhe të gjithë kategorisë së aplikantëve konkretë apo qoftë dhe potencial, të cilët gëzojnë një diplomë, që ka zgjatur, 4 vite akademike (8 semestra), në fushën Biologji-Kimi, Komisioneri e vlerëson si shkak të mbrojtur të LMD-së, referuar si “përkatësi në një grup të veçantë”.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9⁷ të tij “Ndalimi i diskriminimit”, parashikon “përkatësinë në një grup të veçantë” si shkak për të cilin ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

“Çdo shkak tjetër”⁸ përbën shkak, për të cilin Ligji nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesja mbart shkakun e mbrojtur.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesja është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, përse i takon vendosjes së kriterit specifik nr. 2, të vendosur nga Departamenti i Biologji-Kimisë, duke e konsideruar si përjashtues.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

⁷ Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

⁸ Në kontekst të analizës së bërë në faqen 8 të këtij Vendimi.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë *“në gëzimin e të drejtave dhe lirive”* të përcaktuara në të. Protokolli 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.⁹

Karta Social Europiane¹⁰ parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: *“Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht.”*

Në vijim, në nenin 1 të Kartës sanksionohet e drejta për punë dhe në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si racë, ngjyrë, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”*.

Mbrojtjen e parimit të mosdiskriminimit në marrëdhëniet e punës e gjejmë të parashikuar edhe në Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *“Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*, ku në

⁹ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49.

¹⁰ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

interpretim të zgjeruar të saj, ndër të tjera përfshihet edhe mbrojtja nga diskriminimi për shkakun e sipërcituar¹¹.

Duke vijuar më tej, legjislacioni shqiptar e ka përforcuar mbrojtjen nga diskriminimi edhe nëpërmjet parashikimeve me karakter antidiskriminues në akte të tjera, ligjore. Neni 9, i Kodit të Punës¹², parashikon se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me Hiv/Aids, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, geramat a), b), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar në lidhje me procedurat e punësimit për personelin akademik, vërehet se duke analizuar procedurën e ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve për një vend pune në pozicionin e asistent-lektorese së brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, rezultoi se në bazë të tij, përjashtohen nga konkurimi në mënyrë të drejtpërdrejtë kandidatët¹³, që zotërojnë një diplomë, që ka zgatur 4 vite akademike (8 semestra), në fushën Biologji-Kimi, përfshirë edhe ankuesen, duke bërë paragjykes që në fillim, gjithë procesin. Ky veprim krijon dyshimin e arsyeshëm që kandidati fitues të jetë i paracaktuar.

¹¹ Fq 9-10 e vendimit.

¹² Përafshuar pjesërisht me: - Direktivën e Këshillit 91/533/KEE, datë 14 tetor 1991, “Mbi detyrimin e punëdhënësit për të informuar punonjësit për kushtet e zbatueshme në kontratë ose në marrëdhënien e punësimit”. Numri CELEX 31991L0533, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 288, dt. 18. 10. 1991, f. 32 – 35.

- Direktivën e Këshillit 2000/78/KE, datë 27 nëntor 2000, “Mbi krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion”. Numri CELEX 32000L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 303, dt. 2. 12. 2000, f. 16-22.

- Direktivën 2006/54/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 5 korrik 2006, “Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit”. Numri CELEX 32006L0054, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 204, dt. 26. 7. 2006, f. 23-36.

¹³ Kandidatët që kanë konkuruar, po ashtu edhe ata që “hipotetikisht” mund të kishin konkuruar.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur, nga ana e USH-së është vendosur që kriteri, “Master i shkencave” me drejtim “Biologji molekulare” të jetë specifik, atëherë ky kriter duhet të shërbente si kriter vlerësues dhe për rrjedhojë mund të ndryshonte nivelin e pikëzimit, vlerësimit, por nuk duhet të çonte në skualifikimin e kandidatës. Skualifikimi i menjëhershëm i kandidatës dhe mos përfshirja e saj në pikëzim, ka cenuar të drejtën e ankueses për një konkurs të ndershëm e të drejtë nga ana e USH.

Komisioneri vlerëson se kriteret dhe kualifikimet e kandidatëve, duhet të jenë të diferencuara sipas shkallës së kualifikimit të kandidatëve dhe se vendosja e kufizimeve për kandidatët duhet bërë vetëm në rastet kur është absolutisht e nevojshme mbrojtja në veçanti e interesave të rëndësishme të palëve të interesuara dhe duhet që në të gjitha rastet, masa kufizuese e përzgjedhur të përmbajë cënimin më të vogël të mundshëm, me qëllim që t’i sigurohet të gjithë të interesuarve e drejta për të zgjedhur profesionin dhe për të siguruar mjetet e jetesës nëpërmjet punësimit.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3, pika 3, parashikon se: “Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kandidatja dhe të gjithë kandidatët në kushte të njëjta me ankuesen, diskriminohen në mënyrë të tërthortë nga vendosja e kriterit specifik, sipas të cilit kandidati/tët të cilët zotërojnë një diplomë, që ka zgjatur 4 vite akademike (8 semestra), në fushën Biologji-Kimi, skualifikohen që në fazën e parë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të Kodit të Punës nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të L.Dh dhe të gjithë kandidatëve në kushte të njëjta me të, nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.
2. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me vendosjen e kriterit specifik nr.2, në procedurën e konkursit për pozicionin e asistent-lektorese së brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë pranë këtij universiteti, duke përsëritur rishtaz procedurën e punësimit në funksion të gjetjeve të konstatuara në këtë vendim.
3. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të ndryshojë kriterin përjashtues në të gjitha njoftimet për punësim për personel akademik dhe të parashikojë në aktet nënligjore, detyrimin e njësisë bazë për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kriterëve të propozuara, që nga data e daljes së këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA